

VENDIM
Nr. 32, datë 3.2.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “M.C. ENERGJI GOJAN” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, gjerat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 169/2 prot., datë 30.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘M.C. Energji Gojan’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan” me kapacitet të instaluar 15 mw, me vendndodhje lumi Fan i Madh, zona midis fshatrave Shkozë dhe Gojan, Njësia Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë, qarku Shkodër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 169 prot., datë 16.1.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pikën 4.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 7, pika 1

- **germa “e”**: Shoqëria duhet të informojë mbi arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, për garantimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

- **germa “f”**: Shoqëria duhet të informojë mbi efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit.

- **germa “g”**: Shoqëria duhet të informojë mbi efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- **germa “h”**: Shoqëria duhet të risjellë kontratën e kredisë pasi është depozituar në format fotokopje si dhe draft marrëveshjen e Barrës Siguroese, së bashku me listën e detajuar të aseteve fikse.

- **germa “i”**: Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën e bankës për vijimin e veprimtarisë së prodhimit.

- **germa “j”**: Shoqëria duhet të informojë nëse ka pasur transferime më herët.

- **Pika 3**: Shoqëria duhet të depozitojë njoftimin drejtuar MIE-s.

- **Pika 6**: Shoqëria duhet të informojë nëse ka dokumentacion konfidencial.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti